


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Qershor 2017

**Tiranë, më 17 Korrik 2017:** Në Qershor 2017 eksportet e mallrave arritën vlerën 23 mld lekë, duke u ulur me 0,3 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 7,1 %, në krahasim me Maj 2017. Importet e mallrave në Qershor 2017 arritën vlerën 56 mld lekë, duke u rritur me 8,4 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 1,3 %, në krahasim me Maj 2017. Deficiti tregtar i këtij muaji është 34 mld lekë, duke u rritur me 15,1 %, krahasuar me Qershor 2016 dhe me 7,9 %, në krahasim me Maj 2017.

Fig. 1 Qarkullimi i mallrave, Qershor 2015 – Qershor 2017 (%)




Në gjashtë muajt e parë eksportet e mallrave arritën vlerën 133 mld lekë, duke u rritur me 13,5 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 295 mld lekë, duke u rritur me 5,6 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 162 mld lekë, duke u ulur me 0,1 %, krahasuar me 2016.

**Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:**

Rënia vjetore e eksporteve prej -0,3 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -11,4 pikë përqindje dhe “prodhime druri dhe letre” me -0,02 pikë përqindje. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në ndryshimin vjetor të eksporteve, janë: “materiale ndërtimi dhe metale” me +4,5 pikë përqindje, “tekstile dhe këpucë” me +3,8 pikë përqindje dhe “makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,6 pikë përqindje.

**Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Qershor 2017**




Eksportet, gjatë gjashtëmuajorit të parë janë rritur me +13,5 %, krahasuar me gjashtëmuajorin e parë 2016. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “materiale ndërtimi dhe metale” me +5,3 pikë përqindje, “tekstile dhe këpucë” me +3,6 pikë përqindje, “minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,9 pikë përqindje. Grupi që ka ndikuar negativisht në ndryshimin vjetor të eksporteve, është “prodhime druri dhe letre” me -0,1 pikë përqindje.

**Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Rritja vjetore e importeve prej +8,4 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “materiale ndërtimi dhe metale” me +3,7 pikë përqindje, “ushqim, pije, duhan” me +2,4 pikë përqindje, “minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar negativisht grupet: “makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -1,7 pikë përqindje dhe “prodhime druri dhe letre” me -0,1 pikë përqindje.

**Fig. 3 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Qershor 2017**



Importet, gjatë gjashtë muajve të parë, janë rritur me +5,6 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “produkte kimike dhe plastike” me +1,5 pikë përqindje, “tekstile dhe këpucë” me +1,2 pikë përqindje, “ushqim, pije, duhan” me +1,1 pikë përqindje. Grupi që ka ndikuar negativisht në ndryshimin vjetore të importeve, është: “materiale ndërtimi dhe metale” me -0,3 pikë përqindje.

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Qershor 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Qershor 2016 janë: Kosova me (+36,6 %), Spanja me (+218,4 %) dhe Gjermania me (+49,1 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia me (-7,6 %), Greqia me (-20,0 %) dhe Mali i Zi me (-14,3 %).

Gjatë gjashtë muajve të parë, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (+6,3 %) Kosova me (+26,8 %) dhe Spanja me (+167,7 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Zvicra me (-47,0 %), Holanda me (-6,6 %) dhe Kroacia me (-35,0 %).

Në muajin Qershor 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Qershor 2016 janë: Italia me (+3,8 %), Greqia me (+25,2 %) dhe Gjermania me (+8,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kina me (-21,9 %), Shtetet e Bashkuara me (-52,0 %) dhe Rusia me (-23,5 %).

Në gjashtëmujorin e parë, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (+3,8 %), Turqia me (+13,0 %) dhe Greqia me (+10,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Gjermania me (-7,5 %), Kina me (-12,1 %) dhe Shtetet e Bashkuara me (-9,8 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Qershor 2017



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 68,8 %, të gjithë tregtisë. Në Qershor 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 78,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 65,0 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (36,6 %), Greqia (7,7 %), Gjermania (7,5 %) dhe Turqia (5,6 %).

Shkëmbimet tregtare, për gjashtëmujorin e parë, me vendet e BE zënë 66,3 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Qershor 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,8 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 61,6 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (37,3 %), Gjermania (7,2 %), Greqia (7,0 %) dhe Kina (6,2 %).

**Tab. 1 Qarkullimi i mallrave (miliardë lekë)**

Vitet	Muajt	Eksporte	Ndryshimi Vjetor	Importe	Ndryshimi Vjetor	Bilanci Tregtar	% e mbulimit
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-171	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-297	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-301	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2014	01 - 14	18	-1,4	35	2,2	-17	51,2
	02 - 14	20	27,9	39	17,5	-19	51,8
	03 - 14	21	10,4	42	11,1	-21	50,1
	04 - 14	23	10,3	44	6,8	-22	51,3
	05 - 14	25	9,1	48	6,9	-23	52,5
	06 - 14	22	8,3	49	18,9	-27	45,6
	Janar – Qershor 2014	130	10,3	258	10,5	-128	50,3
2015	01 - 15	18	-0,6	35	0,9	-17	50,4
	02 - 15	18	-9,4	39	-0,8	-20	47,3
	03 - 15	22	4,1	44	4,6	-22	49,9
	04 - 15	21	-8,5	44	-1,4	-23	47,6
	05 - 15	24	-4,8	44	-8,0	-20	54,3
	06 - 15	24	7,4	49	-0,8	-25	49,3
	Janar – Qershor j 2015	127	-2,0	256	-1,1	-128	49,8
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-18	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03 - 16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	04 - 16	21	1,7	52	19,0	-31	40,7
	05 - 16	21	-14,8	52	16,7	-31	39,6
	06 - 16	23	-6,4	52	6,2	-29	43,5
	Janar – Qershor 2016	118	-7,7	279	9,3	-162	42,1
2017	01 - 17	19	15,5	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,2	56	7,4	-31	43,6
	06 - 17	23	-0,3	56	8,4	-34	40,0
	Janar – Qershor 2017	133	13,5	295	5,6	-162	45,2

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)**

	Eksporte				Importe			
	Qer.-16	Qer.-17	Jan.- Qer. 2016	Jan.- Qer. 2017	Qer.-16	Qer.-17	Jan.- Qer. 2016	Jan.- Qer. 2017
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>17.717</b>	<b>17.644</b>	<b>91.982</b>	<b>102.516</b>	<b>33.055</b>	<b>36.635</b>	<b>174.128</b>	<b>181.730</b>
Austri	74	99	583	780	573	708	2.820	2.814
Mbretëri e Bashkuar	47	64	226	211	401	481	2.056	2.672
Gjermani	628	936	3.875	5.445	4.593	4.997	27.617	25.558
Greqi	1.243	994	5.607	5.919	4.060	5.082	21.677	24.012
Itali	13.320	12.305	68.331	72.610	15.982	16.589	84.139	87.358
Spanjë	372	1.183	2.433	6.514	1.315	1.358	6.104	6.313
Kroaci	66	104	632	411	420	617	1.937	2.133
Të tjera të BE-së	1.969	1.959	10.294	10.626	5.710	6.802	27.778	30.870
Kinë	555	287	2.402	4.493	5.224	4.079	25.291	22.234
Kosovë	1.346	1.839	7.859	9.966	508	723	2.631	3.836
Maqedonia	568	666	2.786	3.899	616	804	3.392	4.010
Rusi	0	7	46	44	991	758	5.755	4.515
SHBA	110	297	703	1.306	1.687	810	5.262	4.744
Turqi	271	165	729	1.002	4.232	4.252	21.630	24.449
Ukrainë	23	30	93	271	51	192	1.868	1.943
Zvicër	252	50	1.319	699	403	895	3.696	4.139
Të tjera	1.760	1.543	9.679	9.255	5.233	7.223	35.789	43.470
<b>Gjithsej</b>	<b>22.603</b>	<b>22.529</b>	<b>117.597</b>	<b>133.450</b>	<b>52.001</b>	<b>56.370</b>	<b>279.442</b>	<b>295.070</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Qer.-16	Qer.-17	Jan.- Qer. 2016	Jan.- Qer. 2017	Qer.-16	Qer.-17	Jan.- Qer. 2016	Jan.- Qer. 2017
<b>Gjithsej</b>	<b>22.603</b>	<b>22.529</b>	<b>117.597</b>	<b>133.450</b>	<b>52.001</b>	<b>56.370</b>	<b>279.442</b>	<b>295.070</b>
Ushqime, pije, duhan	2.485	2.648	12.024	13.632	8.405	9.632	47.689	50.734
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	5.326	2.757	20.603	22.879	3.967	4.703	23.052	25.207
Produkte kimike dhe plastike	367	388	2.097	2.273	7.133	7.797	39.137	43.370
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	279	286	1.477	1.511	1.951	2.000	8.967	9.617
Prodhime druri dhe letre	640	635	3.822	3.708	2.060	2.004	10.901	10.997
Tekstile dhe këpucë	9.375	10.245	53.664	57.863	7.320	7.949	39.403	42.752
Materiale ndërtimi dhe metale	2.547	3.557	14.864	21.067	5.805	7.711	39.466	38.511
Makineri, pajisje dhe pjesë	935	1.285	5.606	6.974	13.168	12.295	60.640	62.074
Të tjera	649	729	3.441	3.543	2.192	2.279	10.187	11.808

**Tab. 4 Eksportet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Jan.- Qer. 2016, Jan.-Qer. 2017)**

( milionë lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Greqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
<b>Gjithsej</b>	<b>68.331</b>	<b>72.610</b>	<b>7.859</b>	<b>9.966</b>	<b>2.433</b>	<b>6.514</b>	<b>5.607</b>	<b>5.919</b>
Ushqim, pije duhan	3.374	3.179	1.440	1.521	416	395	1.181	878
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	5.168	4.897	1.571	2.848	617	5.046	241	160
Produkte kimike dhe plastike	692	665	653	637	0	3	189	282
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.339	1.172	0	2	3	12	28	37
Prodhime druri dhe letre	2.879	2.610	143	171	3	3	438	536
Tekstile dhe këpucë	43.374	45.767	39	64	1.051	850	2.387	2.622
Materiale ndërtimi dhe metale	6.175	8.375	3.106	3.842	313	200	914	837
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	3.801	4.270	303	333	22	1	34	358
Të tjera	1.529	1.675	603	548	7	5	194	209

**Tab. 5 Importet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Jan.- Qer. 2016, Jan.-Qer. 2017)**

( milionë lekë)

	Itali		Gjermani		Turqi		Greqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
<b>Gjithsej</b>	<b>84.139</b>	<b>87.358</b>	<b>27.617</b>	<b>25.558</b>	<b>21.630</b>	<b>24.449</b>	<b>21.677</b>	<b>24.012</b>
Ushqim, pije duhan	8.249	9.009	2.099	1.940	2.637	2.872	7.314	6.735
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	9.370	7.284	273	291	466	1.104	2.076	3.457
Produkte kimike dhe plastike	8.150	9.315	3.116	3.743	3.095	3.716	3.756	3.987
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	7.066	7.534	2	4	205	175	75	34
Prodhime druri dhe letre	3.120	3.146	408	386	1.494	1.562	1.204	1.390
Tekstile dhe këpucë	20.505	21.859	1.302	1.251	7.031	7.630	1.831	1.903
Materiale ndërtimi dhe metale	8.576	9.983	8.695	4.489	2.544	2.792	3.256	4.414
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	16.253	16.105	10.916	12.547	3.134	3.463	1.394	1.227
Të tjera	2.849	3.124	807	907	1.023	1.135	771	866

# Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin ... e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

÷ deri